



MAGNUM OPUS GROUP

Shoqëria "Magnum Opus Group" sh.p.k.

NIPT: L12205027C

VENDIM

i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k.

Datë 20.06.2014


PËR

**"MIRATIMIN E REZULTATEVE FINANCIARE VJETORE PËR VITIN 2013
DHE DESTINIMIN E FITIMIT PAS TATIMIT"**

Mbledhja e Asamblesë së shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k. e mbledhur në selinë e shoqërisë me pjesëmarrjen e ortakut të vetëm të shoqërisë z.Dritan Agolli, bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar); nenin 33/1 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 për "Tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar); pikën 5.6 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006 për "Tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar); Vendimin e Asamblesë së ortakut të vetëm datë 27.03.2014 për "Miratimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2013" dhe depozituar pranë organeve tatimore brenda datës 31.03.2014; si dhe mbështetur në nenet 7, 9, 12, 14-17 të Statutit të shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Miratimin e **Rezultateve Financiare Vjetore të shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k. për vitin 2013**, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Fitimi që rezulton për vitin ushtrimor 2013, të destinohet për:
 - a) krijimin e fondi të veçantë sipas Statutit në masën 5% e fitimit të realizuar (pas zbritjes së tatimeve dhe shpenzimeve të tjera);
 - b) si dhe për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k.
3. Të ngarkohet eksperti kontabël i autorizuar Studio "A.S.I.E." sh.p.k. (zgj.Sanije Tafa), për hartimin e Raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k.
4. Ky Vendim së bashku me aktet bashkëngjitur, duhet të depozitohet për regjistrim në:
 - a) regjistrin e vendimeve të ortakut të vetëm;
 - b) regjistrin tregtar pranë QKR-së brenda 30 ditëve nga data e këtij vendimi;
 - c) si dhe pranë organeve tatimore brenda datës 31.07.2014.
5. Ngarkohet Administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





MAGNUM OPUS GROUP
Shoqëria "Magnum Opus Group" sh.p.k.
NIPT: L12205027C

VENDIM

i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k.

Datë 30.06.2014

PËR "ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË"

Mbledhja e Asamblesë së shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k. e mbledhur në selinë e shoqërisë me pjesëmarrjen e ortakut të vetëm të shoqërisë z.Dritan Agolli, bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar); nenin 33/1 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 për "Tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar); pikën 5.6 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006 për "Tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar); Vendimin e Asamblesë së ortakut të vetëm datë 20.06.2014 për "Miratimin e rezultateve financiare vjetore për vitin 2013 dhe destinimin e fitimit pas tatimit"; si dhe mbështetur në nenet 6, 7, 9, 10, 14-17 të Statutit të shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k.,

VENDOSI:

- 1. Miratimin e Raportit** të hartuar dhe nënshkruar nga eksperti kontabël i autorizuar Studio "A.S.I.E." sh.p.k. (znj.Sanije Tafa), **për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k.**, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2. Miratimin e ndryshimit të gjendjes së kapitalit të shoqërisë si vijon:**
 - a) Kapitali ishte **4,287,451 lekë** dhe bëhet **6,975,824 lekë**;
 - b) Vlera e një kuote ishte **42, 874.51 lekë** dhe bëhet **69, 758.24 lekë**;
 - c) Fondi i veçantë sipas Statutit ishte **220,392 lekë** dhe bëhet **361,885 lekë**.
- 3. Në Statutin e Shoqërisë "Magnum Opus Group" sh.p.k. (neni 6), të azhurnohet vlera e kapitalit me zmadhimin sipas pikës 2 më sipër.**
- 4. Ky Vendim së bashku me aktet bashkëngjitur, duhet të depozitohet për regjistrim në:**
 - a) regjistrin e vendimeve të ortakut të vetëm;
 - b) regjistrin tregtar pranë QKR-së brenda 30 ditëve nga data e këtij vendimi;
 - c) si dhe pranë organeve tatimore brenda datës 31.07.2014.
- 5. Ngarkohet Administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.**
- 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ORTAKU I VETËMI SHOQËRISË
DRITAN AGOLLI**

